



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 22.10.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesave për ri-shqyrtim të datës 17.10.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.T.SH "MAM" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve diagnostike laboratorike për Njësitë Shëndetësore të burgjeve" me nr. Prokurimi: 206-24-7850-2-2-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.T.SH "MAM" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve diagnostike laboratorike për Njësitë Shëndetësore të burgjeve" me nr. Prokurimi: 206-24-7850-2-2-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 10.10.2024 të publikuar në platformën elektronike.
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 10.10.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.SH "MAM" me datën 10.10.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Servisimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve diagnostike laboratorike për Njësitë Shëndetësore të burgjeve" me nr. të Prokurimit: 206-24-7850-2-2-1. Autoriteti Kontraktues, me datën 22.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues Interlab sh.p.k:

- Nenin 1 – Qëllimi
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Nenin 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
- Nenin 59 - Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve
- NENI 60 – LPP-se
- NENI 61 – LPP-se

Duke u bazuar ne bazen ligjore te lartpermendur kerkojme nga Autoriteti Kontraktues qe te RI-SHQYRTOJE vendimin per dhenie te kontrates te OE PRO MEDICAL SH.P.K. dhe ceshtjen ta kthej ne rivleresim dhe rivendosje ne favorin tone.

Pretendimi ankimore te OE ankues N.T.SH "MAM"

Ne si grup i OE N.T.SH "MAM" & SH.P.K "BIOHIT MDS" kemi marre pjese ne Aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve diagnostike laboratorike për Njësitë Shëndetësore te burgjeve" me nr. prokurimit 206-24-7850-2-2-1.

Pas marrjes se vendimit per tenderuesin e pasuksesshem kemi bere qasje ne dokumentacionin e OE te rekomanduar per kontrate ku pas kontrollimit te cmimeve te ofruara nga OE i rekomanduar per kontrat konsiderojme se cmimet te cilat jane ofruar nga OE i rekomanduar per kontrate jane jo – normalisht te uleta si dhe jo te llogaritura mire.

Po e potencojme edhe njehere se cmimet te cilat jane ofertuar per pjeset reserve te cilat jane specifikuar ne dosjen e tenderit jane jashtzakonisht te uleta, per mos te thene qesharake pasi qe kemi te bejme me nje dallim prej pese deri ne dhjete here me pak se cmimi real i tyre.

Me posht po i cekim disa prej pjeseve reserve te cilat jane kerkuar ne dosjen e tenderit lidhur me aktivitetin e Prokurimit te cekur me larte, ku konsiderojme se cmimet jane shume te lira, te cilat njeherit kane bere qe edhe dallimi total i ofertave te jete i larte, por kjo nuk e pasqyron realitetin.

1. Mythic 18 dhe Mythic 22 / Pllaka kryesore 275.00 Euro

<https://www.aliexpress.com/item/4000315304788.html>

<https://www.ebay.com/itm/384885194942>

2. Cobas c111 / Pllaka CPU 120.00 Euro

<https://www.ebay.com/itm/375566135575>

3. Mindray BC-30s / Pllaka kryesore 250.00 Euro

<https://www.aliexpress.com/item/3256805259917045.html?gatewayAdapt=4itemAdapt>

<https://www.aliexpress.com/i/3256806028062006.html?gatewayAdapt=4itemAdapt>

- Te gjitha keto cmime nga linqet me lart jane cmime referente per pjese te perdorura dhe jo te reja, me c'rast cmimi real eshte edhe me i larte.

Keto jane vetem disa prej artikujve, por te njejta jane edhe shume artikuj te tjere, per mos te thene e tere oferta ne teresi e OE te rekomanduar per kontrate.

Poashtu cmimi total per 1 muaj eshte 2,757.00 Euro qe nese shumezohet per 36 muaj, aq sa zgjat kontrata, shuma do te jete 99,252.00 Euro gje qe e tejkalon buxhetin e parapare per kete aktivitet te prokurimit.

Keto cmime te OE te rekomanduar per kontrate jane cmime jo-normalisht te uleta, pasi qe vlera e ketyre pjeseve te cekuara me lart por edhe e te gjithe artikujve te tjere jane nen cmimin real. Pra me nje fjale keto cmime jane qesharake, pasi qe me keto shuma te ofruara nuk mund te paguhet as transporti apo shpenzimet e importit.

Kjo mund te vertetohet fare lehte nga AK, se a jane keto cmime sipas tregut apo jo.

Prandaj me kete rast konsiderojme se AK sipas LPP ka qene i obliguar ta eliminon OE i cili ka ofertuar keto cmime jo – normalisht te uleta. Pra me kete rast AK ka bere shkelje te nenit 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Si rezultat i shkeljes se nenit 61, kemi edhe shkelje te nenit 59 dhe 60 te LPP-se

Pra AK me kete rast ka bere shkelje te nenit – 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, ku percaktohet se citojme:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Prandaj si rezultat i kesaj, kemi edhe shkelje te nenit 60 duke e shperblyer me kontrate tenderin e papërgjegjshëm , ani pse kerkohet citojme:

1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Prandaj duke u bazuar ne gjitha keto pretendime te cekura me larte dhe te cilat edhe njeherit i kemi faktuar dhe ku kemi deshmuar se ky OE eshte i papergjegjshem kerkojme qe vendimi AK per rekomandim te kontrates te anulohet dhe njeherit lenda te kthehet ne rivleresim dhe te vertetohen ne menyre te detajuar dhe te evidentohen te gjitha keto mashtrime te bera nga ana e OE te rekomanduar per kontrate.

8. Dëmet materiale

Diskrimini per pjesemarrje ne kete aktivitet te prokurimit si dhe dëmet materiale që janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në perspektivë dhe imazh të kompanisë sonë
Kostot e ardhshme deri ne 1% te vleres se njoftimit te kontrates per OSHP. Fitimi i planifikuar për këtë tender.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Ne si Autoriteti Kontraktues i kemi shqyrtuar me kujdes pretendimet e juaja ankimore dhe bazuar ne dokumentacionin e ofertave, sqarimeve te dhena ne procesin e vleresimit dhe legjislacionin ne fuqi, mund te konstatojme se pretendimet e juaja ankimore jane te pa bazuara.

Pretendimet e juaja ankimore kane te bejne me çmimin e ofertes se OE te rekomanduar, qe sipas jushe eshte jo-normalisht të ulët.

Bazuar ne Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, te neni 3, kushti i trete eshte: iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Ne këtë aktivitet kemi vetëm dy ofertues, andaj edhe nuk mund te merren për baze dispozitat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Edhe pse nuk janë plotësuar kushtet e rregullores se lartcekur, kjo çeshtje ka qene subjekt i trajtimit nga ana e AK-MSh dhe gjate procesit te vleresimit, per te qene te sigurte ne vendimarrje, i jemi drejtuar me pyetje sqaruese OE te rekomanduar permes B41 Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, me pyetjet konkrete si me poshtë:

Ne konsiderojmë që tenderi juaj është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës.

Që të mund ta vlerësojmë tenderin tuaj në mënyrën e duhur, ne përputhje me nenin 41.6 të Rregullores së prokurimit publik, kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detaj të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, pra një zberthim të detajuar të pozicioneve, si në vijim:

Ju lutem të sqaroni pozicionet të Pjesa B e Listës së Çmimeve (MIRËMBAJTJA DHE PJESET REZERVE (Furnizimi dhe instalimi I pjesëve):

MIRËMBAJTJA DHE PJESET REZERVE (Furnizimi dhe instalimi I pjesëve)	Njesia matese	Sasia	Çmimi per njesi
Gesan CHEM 200			
Ndrrimi I Tubave te sllikonit 1x3mm,2x4mm	copë	1	25
Ndrrimi I Tubave te pompave peristaltike	copë	1	23
Ndrrimi I Kivetave	copë	1	35
Ndrrimi I kokes se pompave peristaltike	copë	1	60
Ndrrimi I filtrave 340nm,405nm...	copë	1	35
Ndrrimi I kablllove te gilperes	copë	1	45
Ndrrimi I pillakes se diodes	copë	1	100
Ndrrimi I pillakes CPU Board	copë	1	100
Ndrrimi I furnizuesit te rrymes (Power supply).	copë	1	110
Ndrrimi I tubave Teflon.	copë	1	25
Cobas c111			
Shiringa	copë	1	180
Llampa	copë	1	250
Fotodioda e leximit	copë	1	350
Pilaka CPU.	copë	1	120
Mindray BC-30s			
Motorri I vakum pompes	copë	1	25
Membrana e vakum pompes	copë	1	35
Dhomat e leximit(WBC dhe RBC)	copë	1	250
Rrypat komplet	copë	1	15
Ekrani me touch	copë	1	250
Pilaka kryesore	copë	1	250
Valvulat 2 Way	copë	1	65
Valvulat 3 Way	copë	1	60
Mythic 18 dhe Mythic 22			
Ndrrimi I dhomave te leximit WBC dhe RBC	copë	1	200
Pilaka kryesore	copë	1	275
Tube kits	copë	1	110
Membrane Kits	copë	1	80
Motorri I pompes.	copë	1	35
Blood Mixer			
Pilaka kryesore	copë	1	12
Motorri	copë	1	10
Mbajtësi I eprovetave	copë	1	2
Kushineta e motorrit.	copë	1	11
Urisys 1100			
Ekrani me touch	copë	1	40
Ndrrimi I filtrave 565nm,610nm	copë	1	35
Kapaciteti mbajtës I centrifuges	copë	1	45
Koka rrotulluese	copë	1	98
Mikroskop Ashro			
Pjesa levizëse	copë	1	10
Objekthi	copë	1	15
Platforma	copë	1	10

Informatat e kërkuara duhet të pranohen në plaformën e E-prokurimit jo më largë se me datë 07.10.2024.

Nëse nuk marrim përgjigje nga ju mbi pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të dhënë, tenderi juaj do të refuzohet.

Brenda afateve kohore kemi pranuar sqarimet me shkrim nga OE i rekomanduar, i cili çmimet e ofruara ne oferten e tije financiare i ka arsyetuar permes shkreses si ne vijim:



Rr. Kadri Zeka
Ferizaj, 70000, Kosovë
e-mail: promedical.fr@gmail.com
Tel. 049/048-631-245

Lënda : Informacione shtës për Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët

Për : Zyrën e Prokurimit

Nga : PRO MEDICAL

Data : 06.10.2024

Nr.Prokurimit : 206-24-7850-2-2-1

Titulli : Servisimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve diagnostike laboratorike për Njësitë Shëndetësore te burgjeve

Informacione shtës dhe sqarim për ofertë

Ne Pro Medical, si pjesëmarrës në tenderin me titull "*Servisimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve diagnostike laboratorike për Njësitë Shëndetësore të burgjeve*" dhe me numër të prokurimit #206-24-7850-2-2-1, dhe duke u bazuar në shkresën tuaj të datës 02.10.2024 lidhur me B41 Letër Standarde të kërkesës për informacion mbi tenderët, dëshirojmë t'ju sigurojmë sqarime dhe informacione shtesë si më poshtë.

Duke u mbështetur në faktorët dhe politikat financiare të kompanisë, në këtë proces prokurimi kemi ofruar çmime reale të tregut. Ju, si Autoritet Kontraktues (AK), nuk mund të bëni krahasime në këtë proces prokurimit ku janë vetëm dy oferta, pasi oferta tjetër mund të ketë çmime më të larta se çmimi i tregut. Pro Medical ka ndjekur një qasje të ndershme dhe të bazuar në vlerësimin real të tregut.

Gjithashtu, duhet të keni parasysh se edhe Rregullorja për Prokurimin Publik 2022, Neni 27.15, thotë: "*Nuk lejohet krahasimi i çmimeve të ofertave të udryshme me njëra-tjetrën dhe të konvertohen vlerat e llogaritura në pikë, maundej të peshohen pikët, pasi në këtë mënyrë pikët më të larta të poentuara jo domosdoshmërisht do të rezultojnë në çmimin më të ulët.*"

Pro Medical bazohet në një marzh fitimi të arsyeshëm dhe të balancuar, që varion nga 18-25% për pjesët rezervë, dhe një marzh fitimi prej 26-29% nga shërbimet, ndërsa ±6% ndahet proporcionalisht për të mbuluar shpenzimet për pjesët rezervë. Sipas procedurave të kompanisë, 5-8% e të ardhurave nga shërbimet e servisimit janë dedikuar për të mbuluar çdo lëvizje të paparashikuar të tregut. Ky nivel i marzhit të fitimit është në përputhje me standardet e tregut dhe sjell përfitime të dukshme për ne si kompani.

Është e rëndësishme të theksojmë se oferta jonë është në përputhje me çmimet reale të tregut në Kosovë. Ndërsa ofertat nga operatori e tjerë ekonomikë mund të jetë e lart, kjo ka bërë që oferta jonë të duket më e lirë, por nuk mund të konsiderohet si ofertë e ulët sepse është konform çmimeve të tregut.

Në vijim, do t'ju informojmë dhe do të elaborojmë ofertën tonë në tre pjesë, si më poshtë, duke shpjeguar gjithashtu arsyet pse oferta jonë është më e favorshme:

Pjesa I: Do t'ju informojmë mbi qëllimet, kapacitetet teknike dhe profesionale të kompanisë.

Pjesa II: Do t'ju informojmë për shpenzimet operative dhe për shpenzimet e tjera.

Pjesa III: Deklarata mbi ofertën dhe sigurojmë se oferta jonë do të përmbushet ashtu siç është cekur në Dosjen e Tenderit (DT).

PJESA I: Qëllimi, kapacitetet teknike dhe profesionale të Pro Medical.

Qëllimi kryesor dhe primar i kompanisë sonë, Pro Medical është të ofrojë shërbime cilësore për instucionet publike në Kosovë me çmime të bazuar në treg dhe me një fitim ekonomik të arsyeshëm dhe optimal për kompaninë tonë.

Disa elemente kyçe që e bëjnë ofertën tonë më të përballueshme janë:

Disa pajisje kërkojnë mirëmbajtje rutinore, pasi janë të cilësisë më të lartë. Duke ndjekur procedurat e servisimit dhe mirëmbajtjes së parashikuara nga AK, parandalohen defektet e pajisjeve, veçanërisht pasi shumica e pjesëve të tyre nuk janë për konsumues/ harxhues të përditshëm, përveç disa llampave që kanë jetëgjatësi të kufizuar. Për të siguruar funksionimin e tyre të qëndrueshëm, është e mjaftueshme të kryhet servisimi dhe mirëmbajtja periodike, të cilën e kemi parasysh dhe respektojmë sipas udhëzimeve të AK.

Stafi Permanent: Ne kemi një staf të përhershëm, që nuk ka nevojë për angazhim të shtesë apo nënkontraktorë, pra kjo na siguron që nuk do të ketë ndonjë rritje të koston përmes palëve të treta.

Pjesa e Rezervuar në Stok: Në kuadër të këtij tenderi, disponojmë një stok të mjaftueshëm për të garantuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në shërbimet e ofruara për disa pajisje, duke pasur gjithashtu burime të sigurta furnizimi. Ky avantazh na bën konkurrues në aspektin financiar, duke ulur ndjeshëm koston dhe duke rritur efikasitetin në zbatimin e shërbimeve.

Përvoja dhe Përkushtimi: Ne kemi një përvojë të gjerë dhe sukses të konstatuar me instucionet publike të Kosovës dhe me kontrata të ngjashme, siç janë QKMF-ja Ferizajt, QKMF-ja Istogut, QKMF-ja Vitisë, QKMF Podujeve, QKMF Lipjan, QKMF Vushtri, QKMF Gjilan, QKMF Han i Elezit, FSK, QKMF Shtime, QKMF Junik, QKMF Gjakovë, Ministrin e Shëndetësisë, Luxemburg si fondin Lux Dev, KFOR Italiana dhe disa ordianca dhe klinika private. Ky sukses tregon se jemi në gjendje të sigurojmë shërbime cilësore dhe të qëndrueshme, ju lutem shikoni listën e kontrateve, shikoni listën e projekteve të servisimit ku vlera total e kontratave është mbi 400,000 euro.

Hulumtim Paraprak dhe Vlerësim Teknik: Para se të prezantojmë ofertën tonë, kemi bërë hulumtime paraprake dhe vlerësime teknike për të siguruar që pajisjet mjeksore që ofrojmë nuk kanë rreziqe të mëdha për shërbimin, riparim dhe mirëmbajtje. Kemi përdorur analizë të detajuar dhe kalkulime financiare për të garantuar që kemi përfshirë të gjitha koston relevante.

Stabilitet Financiar dhe Kontrata Stabile: Ne jemi një kompani e besueshme dhe rreziku i mospagimit të detyrimeve është minimal miha AK. Kontrata është e stabilizuar dhe ka një kohëzgjatje të gjatë prej tre vjetësh.

Përkushtimi për Shërbimet Publike: Oferta jonë është për të siguruar shërbime servisimi të pajisjeve mjeksore që përdoren për shërbime publike dhe për institucione publike me interesa të përgjithshme. Për të ndërthurur interesat publike, kemi ofruar çmime të bazuar në tregun real.

Duke u bazuar në faktorët e përmendur më lart dhe politikat tona financiare, kemi paraqitur një ofertë me çmime të arsyeshme dhe të bazuara në treg. Në një kohë kur disa pjesëmarrës të tjerë në këtë tender ofrojnë çmime tejet të larta, ne synojmë të ofrojmë një zgjidhje të drejtë dhe të favorshme si për ne, ashtu edhe për AK.

PJESA II: Elaborimi dhe Analiza e Shpenzimeve Operative dhe të tjera

Në këtë pjesë të ofertës, do të fokusohemi në elaborimin dhe analizimin e shpenzimeve operative dhe të tjera për këtë projekt.

Shpërndarja e Shpenzimeve Operative: Ne kemi kryer një analizë të thellë të shpenzimeve operative dhe kemi arritur një shpërndarje proporcionale të tyre. Kjo shpërndarje e përshtatshme siguron një qasje të qëndrueshme ndaj shpenzimeve dhe kontribuon në ofertën tonë konkurruese.

Çmimet për Pjesë Rezerve: Çmimet tona për blerjen e pjesëve rezerve janë të volitshme dhe të përshtatshme me kërkesat e tregut. Ky aspekt i ofertës sonë ndihmon në uljen e koston totale dhe në ofrimin e një zgjidhje të qëndrueshme për instucionet publike.

Riparimi dhe Servisini i Paisjeve Mjeksores; Riparimi dhe servisini i paisjeve mjeksores është një aspekt i rëndësishëm i ofertës sonë. Përvoja jonë e suksesshme me riparimin dhe servisin të paisjeve të ngjashme në kontratat që kemi me QKMF-ja tregon aftësinë tonë për të ofruar shërbime cilësore dhe të besueshme.

Shpenzimet Rrugore dhe Lokacioni Strategjik; Në lidhje me shpenzimet rrugore, ne kemi përcaktuar që ato janë minimale për shkak të distancës. Kjo pozicion taktik na lejon të minimalizojmë shpenzimet e rrugore dhe kohën e duhur për të arritur në vendet e shërbimit.

Në përfundim, ne ofrojmë një analizë të detajuar të shpenzimeve operative dhe të tjera, për të garantuar një ofertë të qëndrueshme dhe të përballueshme për institucionet publike. Përvoja jonë e mëparshme dhe aftësia për të zbatuar me sukses kontrata të ngjashme na japin besimin se mund të ofrojmë shërbime cilësore, duke siguruar që shpërndarja e shpenzimeve dhe fitimit të bëhet në mënyrë proporcionale dhe të drejtë. Fitimi ynë është optimal dhe në përputhje me procedurat e kompanisë, pa abuzuar me fondet publike apo me institucionet shëndetësore, pasi shërbimet tona janë të orientuara drejt interesit publik.

Fitimi neto për këtë tender është parashikuar të jetë në intervalin 28-32%, që përputhet me standardet dhe normat e lejuara.

PJESA III: DEKLARATA PËR OFERTËN

Unë, si përfaqësues i Operatorit Ekonomik "Pro Medical", përfaqësuar nga Adnan Bala, deklaroj me këtë dokument se jemi të përkushtuar dhe të gatshëm për të përmbushur kontratën e shërbimeve sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues, të specifikuar në kontratë. Ne angazhohemi të respektojmë dhe të zbatojmë të gjitha termat dhe kushtet e përcaktuara në detajet e kontratës.

Deklarojmë gjithashtu se jemi të gatshëm të qëndrojmë besnikë ndaj çmimeve të ofruara dhe të sigurojmë kryerjen e kontratës në përputhje me këto çmime, të paraqitura në dokumentin e tenderit me titull Servisini dhe Mirëmbajtja e pajisjeve diagnostike laboratorike për Njësitë Shëndetësore të burjeve.

Duke u bazuar në sqarimet dhe provat e paraqitura më lart, besojmë se Autoriteti Kontraktues do të marrë në konsideratë këto sqarime dhe do të vlerësojë ofertën tonë në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike (LPP), Neni 59 dhe Neni 61, paragrafi 3, si dhe Neni 6, paragrafi 1, që citon: "Të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit."

Gjithashtu, në përputhje me Nenin 4 të RRPP-së, paragrafi 4.1, "alineja c, deklarojmë se çmimi i kontratës që kemi ofruar është në përputhje me çmimet e tregut dhe nuk tejkalon ato"

Autoriteti Kontraktues duhet të ketë si qëllim ruajtjen e buxhetit, duke pasur parasysh gjithashtu Nenin 6 të LPP-së.

Nëse ju si Autoritet Kontraktues keni nevojë për informacione shtesë, ju lutem na kontaktoni. Jemi në dispozicionin tuaj lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Pro Medical - Adnan Bala, Dësitor.....



Bazuar ne arsyet e lartcekura, ne si AK-MSh nuk kemi mund te veprojmë ndryshe, meqenëse OE i rekomanduar ka dhënë sqarimet e nevojshme dhe zotimin e tij per realizimin e kontratës.

Oferta e OE te rekomanduar eshte: A- 2,757.00 + B- 5,715.00 ne total = 8,472.00 €.

Ndërsa oferta juaj eshte: A- 1,150.00 + B- 14,800.00 ne total = 15,950.00 €.

Kërkesën për rishqyrtim fillimisht ju e keni bere adresuar vetëm përmes emailit me datën 14.10.2024 e nuk e keni ngarkuar ne e-prokurim.

Për shkak te korrektësisë ne ua kemi mundësuar dhe u kemi dhënë afat shtese edhe 2 dite, deri me dt. 17.10.2024 ora 16:00 qe ankesën ta bëni përmes platformës.

Kjo tregon se vendimi i AK është në përputhje të plotë me nenin 59, 60, 61 te LPP-në.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit